

V E N D I M
PER REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Sot, me date 24.08.1994, ne Gjykatën e Rrethit Tirane, une Dr. A. Cops
Cops gjyqtare e kesaj gjykate, pasi u njoha me materialet e paraqitura nga Emin Tasim Toçi nga Tirana per te bere regjistrimin si person juridik te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar " E L B A " SH.P.K.;

K O N S T A T O V A

Kerkuesi Emin Toçi, ortak i vetem ka themeluar Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar "ELBA" me seli ne Tirane dhe me te drejte per te ushtruar aktivitetin e saj ne te gjithë teritorin e Republikës se Shqiperise dhe jashte saj, me kohe zgjatje mbi 10 vjet, me kapital themeltar 100.000 l. ke, me administrator Emin Tasim Toçi dhe me aktivitet qe konsiston ne tregtimin e materialeve dhe prodhimeve te ndertimit, import eksport, ne fushen e ndertimit si dhe çdo aktivitet tjetër, qe veçmas ose se bashku me ato te permendura mesiper do te konsiderohen te pershtatshme dhe me leverdi per rritjen e zhvillimin e shoqerise.

Meqense kerkesa e tij per regjistrimin e kesaj shoqerie eshte e drejte si e till ajo duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Ne baze te Ligjit Nr.7638, date 19.XI.1992 dhe Ligjit Nr.7667, date 28.01.1993;

V E N D O S A

Regjistrimin si person juridik te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "ELBA", me ortak te vetem Emin Tasim Toçi, me seli ne Tirane dhe me te drejte per ta ushtruar aktivitetin e saj ne te gjithë teritorin e Republikës se Shqiperise dhe jashte saj, me kohe zgjatje mbi 10 vjet, me kapital themeltar 100.000 leke, me administrator Emin Tasim Toçi dhe me aktivitet qe konsiston ne tregtimin e materialeve dhe prodhimeve te ndertimit, import eksport, ne fushen e ndertimit si dhe çdo aktivitet tjetër qe veçmas ose se bashku me ato te permendura mesiper do te konsiderohen pershtatshme dhe me leverdi per rritjen e zhvillimin e shoqerise.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim.

G J Y Q T A R E

Dr. A. Cops

Cops

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE
Nr. 5914/11 vendimit

V E N D I M
I G J Y Q T A R I T T E V E T E M

Sot me daten 30/05/2007 Une Gjyqtare e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane J. Hoxha, pasi shqyrtova dokumentet e paraqitura nga shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "ELBA" shpk me Administrator te Pergjithshem: **Z.Emin Toci**,madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, per depozitim e dokumentave te shoqerise,

V E R E J :

Me vendim te Gjykates se Rrethit Tirane nr.5914 date 24.8.1994 eshte themeluar shoqeria "ELBA" shpk me objekt te percaktuar me hollesisht ne vendimin e saj.

Duke u mbeshtetur ne Ligjin 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" ortakut i vetem i shoqerise me vendimin date 10.5.2007 ka vendosur :

- 1- **Fillimin e procedures per rritjen e kapitalit te shoqerise me fitimet e pashperndara.**
- 2- **Caktimi i Z.Bujar Bendo,eksperte kontabel i autorizuar per pergatitjen e raportit te vecante per rritjen e kapitalit.**

*Depozitim e kerkeses prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Nga dokumentet e paraqitura rezulton se kerkesa eshte e drejte dhe e bazuar ne Ligj dhe si e tille te pranohet.

P E R K E T O A R S Y E

Ne mbeshtetje te Ligjit Nr.7667 date 28 janar 1993 dhe Ligjit Nr.7638 dt.19.11.1992

V E N D O S A

*Pranimin e kerkeses.

*Depozitim e vendimit te ortakut te vetem te shoqerise date 10.5.2007,licensa e ekspertit te paraqitura nga shoqeria "ELBA" shpk duke u bere shenimet perkatese ne fleten e regjistrimit ne kollonen 4 e kollona 5, te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

G J Y Q T A R E

J. Hoxha
05/04

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE
Nr. 5914/2 vendimit

V E N D I M
I G J Y Q T A R I T T E V E T E M

Sot me daten 20/7/2007 Une Gjyqtare e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane **Majlinda Dogga**, pasi shqyrtova dokumentet e paraqitura nga shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "ELBA" shpk me Administrator te Pergjithshem: **Z.Emin Toci**, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, per depozitimin e dokumentave te shoqerise,

V E R E J :

Me vendim te Gjykates se Rrethit Tirane nr.5914 date 24.8.1994 eshte themeluar shoqeria "ELBA" shpk me objekt te percaktuar me hollesisht ne vendimin e saj.

Duke u mbeshtetur ne Ligjin 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" ortaku i vetem shoqerise me vendimin date 1.6. 2007 ka vendosur :

1-Miratimin e raportit te ekspertit per vleresimin e kapitalit.

2-Miratimi i shteses se kapitalit ne vleren 12.400.000 leke duke arritur ne kete menyre kapitali i shoqerise ne shumen 12.500.000 leke".

3-Zgjatjen e afatit te veprimtarise se shoqerise me nje afat te pacaktuar.

*Depozitimin e kerkeses prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Nga dokumentet e paraqitura rezulton se kerkesa eshte e drejte dhe e bazuar ne Ligj dhe si e tille te pranohet.

P E R K E T O A R S Y E

Ne mbeshtetje te Ligjit Nr.7667 date 28 janar 1993 dhe Ligjit Nr.7638 dt.19.11.1992

V E N D O S A

*Pranimin e kerkeses.

*Depozitimin e vendimit te ortakut te vetem te shoqerise date 1.6. 2007, raporti i ekspertit te paraqitura nga shoqeria "ELBA" shpk duke u bere shenimet perkatese ne fleten e regjistrit ne kollonen 4 e kollona 5, te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

G J Y Q T A R E
MAJLINDA DOGGA





AKTI I THEMELIMIT TE SHOQERISE
"ELBA" sh.p.k IMPORT-EXPORT

Sot, më datë 17.VIII.1994, unë i quajtori Emin Toçi, i biri i Tasimit, lindur më 1951, banues në Tiranë në Rrg."Muhamet Gjollesha", P.35, Shk.2, Ap.8 themeloj shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar si ortak i vetëm.

Neni 1

Shoqëria emërohet "ELBA" sh.p.k. IMPORT EXPORT.

Neni 2

Selia e Shoqërisë është në Tiranë, në Rrg."Muhamet Gjollesha", P.35, Shk.2, Ap.8. Me të drejtë për të ushtruar aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

Neni 3

Shoqëria ka një aktivitet të saj tregtar mbi dhjetë vjet dhe mund të shpërbëhet në çdo kohë.

Neni 4

Shoqëria ka për aktivitet të saj:
- Tregtimin e materialeve dhe të prodhimeve të ndërtimit, Import-Eksport, si dhe veprimtari në fushën e ndërtimit.
Si dhe çdo aktivitet tjetër, që veças ose së bashku me ato të përmendura mësipër do të konsiderohen të përshtatshme dhe me leverdi për rritjen e zhvillimin e firmës.

Neni 5

Kapitali i shoqërisë është 100 000 leke.

ORTAKU I VETEM

EMIN TOCI



STATUTI I SHOQERISE

"ELBA" sh.p.k IMPORT-EXPORT

(Ortak i vetëm)

FORMIMI

Neni 1

Formohet Shoqeria tregtare me emertimin "ELBA" me Përgjegjësi të kufizuar e themeluar nga ortaku i vetëm Zoti Emin Toçi, i biri i Tasimit, i lindur më 1951, banues në Tiranë në Rrg."Muhamet Gjollesha", P.35, Shk.2, Ap.8.

SELIA E SHOQERISE

Neni 2

Selia e Shoqërisë është në Tiranë, në Rrg. "Muhamet Gjollesha", P.35, Ap.8.

Ajo ka të drejtë që të ushtrojë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

KOHE ZGJATJA

Neni 3

Kohe zgjatja e veprimtarisë ekonomike të Shoqerisë është mbi dhjetë vjetë dhe mund të shpërbëhet në çdo kohë.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Neni 4

Veprimtaria tregtare e shoqërisë është sa vijon:

- Tregtimin e materialeve dhe të prodhimeve të ndërtimit, Import-Eksport si dhe veprimtari në fushën e ndërtimit.

Si dhe çdo aktivitet tjetër që veças ose së bashku me ato të përmendura më sipër do të ndikojnë në zhvillimin e rritjen e veprimtarisë së shoqërisë.

Neni 5

saj.

KAPITALI I SHOQERISE

Neni 6

Kapitali i shoqerisë është 100 000 leke i formuar në masën e plotë nga ortaku i vetëm.

Neni 7

Kapitali i shoqerisë mund të shtohet ose të pakësohet sipas vendimeve që do të marrë ortaku i vetëm.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Neni 8

Shoqëria, deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave që përmban ky statut dhe ato të legjislacionit shqiptar në fuqi. Shoqëria, fiton zotësinë për të vepruar me regjistrimin e saj si person juridik në Gjykatën e Tiranës dhe ndërsa ushtron aktivitetin tregtar me regjistrimin në Zyrën e Tatimeve.

Neni 9

Shoqëria ka vulën e saj me përmbajtjen SHOQERIA TREGTARE "ELBA" sh.p.k. IMPORT-EXPORT.

Neni 10

Shoqëria tregtare, vepron në regjimin e pronës dhe merr përsipër vetë të drejtat e detyrimet.

Ajo përgjigjet vetë për detyrimet e saj kontraktore e jashtë kontraktore brënda kapitalit të saj. Ortaku i vetëm mbart rrezikun e veprimtarisë së shoqerisë në nivelin e shumës së mjeteve të investuara në shoqëri.

Neni 11

Shoqëria, është pronë e themeluesit të saj. Ajo merr vendime në zbatim të ligjeve në fuqi dhe sipas këtij statuti, të cilat janë të detyrueshme për të gjithë punonjësit në këtë





Neni 12

Ortaku i vetëm sipas nevojave që paraqiten për zhvillimin e veprimtarisë së shoqërisë, emëron Administrator EMIN TOCIN si dhe punëson punonjës të veprimtarive të ndryshme ekonomike të përmendura në nenin katër të këtij statuti.

Neni 13

Ortaku i vetëm i shoqërisë dhe Administratori i ngarkuar prej tij janë të veshur me të gjitha fuqitë për drejtimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë pa asnjë lloj kufizimi. Ai ka mundësi të kryejnë të gjitha aktet që konsideronë të nevojshme për arritjen e qëllit të shoqërisë, Ai ka të drejtë midis të tjerash të bleje e të këmbeje pasuri, të lidhet me shoqëri të tjera të vëndit ose të huaja, të kryej çdo lloj veprimi pranë të gjitha zyrave private apo shtetërore që kanë të vëjnë me garancitë, ipotekat. Të kryej pranë instituteve bankare e financiare veprime depozitimi, kreditimi, pagesa dhe arkëtimi. Në këto raste Administratori i ngarkuar ka për detyrë të njoftojë dhe t'i japë llogari ortakut të vetëm.

Neni 14

Përfaqësimi i shoqërisë i përket ortakut të vetëm dhe Administratorit të ngarkuar. Ai ka të drejtën e përfaqësimit të shoqërisë në organet gjyqësore dhe administrative, të caktojnë e të pushojnë avokat për çdo problem.

BILANCI DHE TË ARDHURAT

Neni 15

Veprimet ekonomike e financiare të shoqërisë mbyllen në 31



bilancin kontabël të shoqërisë me llogarinë FITIM HUMBJE, mbështetur në ligje dhe rregulla të mbajtjes së kontabilitetit nga subjektet private përcaktuar nga organet kompetente të sistemit fiskal.

Bilanci kontabël miratohet nga ortaku i vetëm, i cili vendos për krijimin e fondeve të ndryshme të nevojshme për zhvillimin e garancinë e veprimitarisë së shoqërisë, fondin e akumulimit, fondin rezervë etj.

Neni 16

Të ardhurat neto pas veçimit të fondeve ligjore të përmendura më sipër dhe shlyerjen e detyrimeve fiskale nga fitimi i mbesin për përdorim ortakut të vetëm.

SHPËRNDARJA E SHOQËRISË

Neni 17

Shpërbërja e Shoqërisë mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak si humbja e kapitalit, pamundësi veprimitarie etj. Në këto raste ortaku i vetëm vendos mbi mënyrën e likuidimit dhe cakton një ose më shumë likuidatorë. Këta bëjnë kujdes që shoqëria të likujdojë më parë detyrimet që ajo ju ka personave të tretë fizik e juridik.

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 18

Përsa nuk është shprehur në këtë statut i referohet plotësimeve nga ortaku i vetëm si dhe ligjeve përkatëse shqiptare.

Neni 19

Ky statut përpilohet në disa kopje për t'ju shpërndarë organeve kompetente ndërsa një kopje mbetet si pjesë përbërse e dokumentacionit të themelimit të shoqërisë.

ORTAKU I VETEM

EMIN TOCI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr. 4615 Rep



VERTETIM

Sot me daten 4/6/2007 ne Zyren e Noterise Tirane perpara meje noteres Mimoza Shehu u paraqit personalisht eksperti kontabel **Bujar Bendo i** cili deklaroi se akti sa siper eshte nenshkruar prej tij me vullnetin e tij te lire dhe te plote dhe une noterja pasi u binda per identitetin e tij legalizoj nenshkrimin sipas ligjit.



Shoqeria Private" ELBA "shpk TIRANE
Kapitali Themeltar 100.000 leke
Administrator z.Emin Toci TIRANE

RAPORT I VECANTE EKSPERTIT

Per zmadhim kapitali te shoqerise "ELBA "shpk . TIRANE

Me vendim te mbledhjes se Asamblese se Ortakeve te Shoqerise private "ELBA "sh.p.k me seli ne TIRANE, e perfaqesuar nga ortaku ivetem z **Emin Toci** dhe njekohesisht administrator ,na ka caktuar si ekspert per te perpiluar raportin e vecante ne lidhje me zmadhimin e kapitalit duke u nisur nga gjendja faktike e pasurise se Shoqerisene fund te vitit 2006. Zmadhimi I kapitalit do te kete si burim fitimet e mbartura te Shoqerise deri ne fund te vitit 2006.

Une ,Bujar Bendo, me cilesine e Ekspertit Kontabel te Autorizuar ,I licensuar me nr.79 dt 12.04.2000 te Komisionit te Regjistrimit prane IEKA, pranuan misionin e percaktuar nga Ortaku I Vetem i Shoqerise "ELBA "shpk, duke patur parasysh dhe nenet 168 e 169 mbi papajtueshmerine mbi emerimin e Ekspertit kontabel te Autorizuar ne baze te ligjit nr 7638 date 19.11.1992 "Per "Shoqerite Tregtare."
Me cilesine e Ekspertit Kontabelte Autorizuar per te bere kete Raport te Vecante per zmadhimin e kapitalit te shoqerise jemi mbeshtetur ne keto dokumenta :

1. Dokumenta ligjore

- Vendim Gjykate nr 5914 date 24.08.1994 per regjistrimin ne regjistrin tregtar te shoqerise.

- Statut dhe Akt-themelimi te Shoqerise

- Certifikata e regjistrimit ne organin Tatimor me kod Fiskal.

- Numri I identifikimit te personit Tatueshem.

- Vendimin e Ortaku te Vetem te Shoqerise per emerimin si Ekspert.

2. Dokumenta Ekonomik .

- Bilancin e fund vitit 2006.

- Raportin e Ekspertit kontabel mbi opinionin e Bilancit te vitit 2006.

- Ne inventaret Kontabel te aktiveve dhe pasiveve te perpiluara nga shoqeria e te rishikuara nga ana e jone mbi vleresimin e tyre.

- Cdo document apo informacion I kerkuar nga ana e jone ne mbeshtetje te ketij Raporti.

Bilanci I rishikuar nga ana e jone eshte e paraqitur me poshte dhe perben bazen e ketij raporti. Bilanci I ushtrimit 2006 I shoqerise "ELBA "shpk me seli ne TIRANE.

I- Rritja e kapitalit nga Fitimi

Duke u nisur nga dokumentat e kontrolluara dhe te vertetuara, kontabilizimet, ne pozicionin e duhur ,opinionin e Ekspertit ne lidhje me Llogarite vjetore 2006, rezulton se ne Pasiv te bilancit ,ne grupin e Kapitaleve te Veta ,fitimet e realizuara paraqiten:

Kapiatli i nenshkruara ne shumen 100.000 leke
Fitimi I mbartur me vlefte 8.462.443 leke
Fitimi ushtrimor 2006 ne shumen 4.569.016 leke

Ortaku I Vetem I Shoqerise ka vendosur qe shumen e fitimeve te mbartura me vlefte 8.462.443 leke dhe fitimeve te realizuara nga aktiviteti deri ne fund te vitit 2006, me vlefte 4.569.443 leke, ta kaloje , Gjithsej 13.058.459 leke ta kaloje :

- a) Ne rezerva ligjore 5% ose 658.459 leke.
b) Ne zmadhim te Kapitalit Themeltar te Shoqerise me vlefte 12.400.000 leke
Si rezultat I ketyre veprimeve dhe I vendimit te Ortakut te Vetem te Shoqerise ne ngjarjet ekonomoke te vitit 2006 do te kryhet ky veprim Kontabel:

Debi Llogaria 107 "Fitime I mbartur" per 8.462.443 leke.
Debi Llogaria 121 "Fitime te ushtrimit" per 4.569.016 leke.
Kredi Llogaria 101 "Kapitali I nenshkruar" per 12.400.000 leke.
Kredi "Llogaria rezerva ligjore" per 658.459 leke.

Ne perfundim Shoqeria "ELBA" sh.p.k do te beje zmadhimin e kapitalit ne shumen 12.400.000 leke dhe ne total kapitali I Ortakut te vetem eshte :

Kapitali I nenshkruar	100.000 leke
Shtese kapitali	12.400.000 leke
Totali	12.500.000 leke

Zoterues I ketij kapitali prej 12.500.000 leke jeshte ortaku I Vetem I shoqerise "ELBA" sh.p.k TIRANE

PJESMARRJA NE KAPITALIN E SHOQERISE

Ne baze te vendimit te gjykates nr 5914 date 24.08.1994 rezulton se ortaku i vetem i shoqerise zoteron 100% te kuotave te kapitalit te shoqerise .

Ortakut te vetem i Shoqerise " ELBA" sh.p.k me seli ne TIRANE eshte personi juridik.

Pas zmadhimit te kapitalit te shoqerise pjesmarrja ne kapital rezulton si vijon:

	Ishte	Behet
Kapitali themeltar (000/leke)	100	12.400

Ky mision i zmadhimit te kapitalit u krye ne baze te vendimit te Gjykates TIRANE Nr 5814 date 30/5/2007

Ky raport u behet I njohur Ortakut te Vetem te Shoqerise dhe Administratorit te saj per te kryer veprimet e duhura ne kontabilitet dhe ne regjistrin tregtar prane Gjykates.

TIRANE , me dt 16 2007.

Ekspert Kontabel I Autorizuar
z. Bujar Bendo

EKSPERT KONTABEL
I AUTORIZUAR
BUJAR BENDO
Tel. _____

VENDIM I ORTAKUT TE VETEM
date 16 2007

Sot me dt 16 2007, behet mbledhja e ortakut te vetem te shoqerise "ELBA" shpk,

Eshte i pranishem :

Z.Emin Toci i cili zoteron 100% te kuotave te shoqerise

Shoqeria "ELBA" sh.pk eshte themeluar me vendimin 5914 date 24.8.1994, me ortak te vetem Z.Emin Toci.

Mbledhja ka per rend dite :

- 1-Miratimin e raportit te ekspertit per vleresimin e kapitalit.
- 2-Miratimi i shteses se kapitalit ne vleren 12.400.000 leke duke arritur ne kete menyre kapitali i shoqerise ne shumen 12.500.000 leke".
- 3-Zgjatjen e afatit te veprimtarise se shoqerise me nje afat te pacaktuar.

Ortaku i vetem i shoqerise

V E N D O S I

- 1-Miratimin e raportit te ekspertit per vleresimin e kapitalit.
- 2-Miratimi i shteses se kapitalit ne vleren 12.400.000 leke duke arritur ne kete menyre kapitali i shoqerise ne shumen 12.500.000 leke".
- 3-Zgjatjen e afatit te veprimtarise se shoqerise me nje afat te pacaktuar.

Depozitimim e ketij vendimi prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE
EMIN TOCI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Notere Mimoza Shehu

Nr. 1578 Rep.

Nr. - Kol.

V E R T E T I M

Sot me daten 16 /2007 , ne zyren e Noterise Tirane ,perpara meje Noteres Mimoza Shehu, u paraqit personalisht Emin Toci me cilesine e Ortakut te shoqerise "ELBA"sh.pk i cili deklaroi se sa siper eshte deklarim i vullnetit te tij e nenshkroi ne pranine time dhe une noterja legalizoj nenshkrimet sipas ligjit.

Z. M. Dajpe
dt. 04.06.2007
04 GIU. 2007

K E R K E S E

KERKUESI: Emin Toci madhore me zotesi te plote juridike , per te vepruar me cilesine e ortakut dhe administratorit te shoqerise "ELBA " sh.p.k Tirane.

OBJEKTI : Depozitimin ne Rregjistrin Tregetar te Vendimit dt. 11/06/2007 Ortakut te Vetem te shoqerise "ELBA " sh.p.k Tirane.

Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

Me vendimin Nr 5914 dt 24.08.1994 te Gjykates se Rrethit Tirane eshte rregjistruar si person juridik shoqeria "ELBA " sh.p.k Tirane, me ortake dhe administrator Kapiatali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke , te cilen e zoteron 100 % ortakut i vetem z. Emin Toci

Aktualisht Ortaku i Vetem i shoqerise "ELBA " sh.p.k Tirane me vendimin date 31.8. 2007 ka vendosur :

1. Miratimine Raportit te Ekspertit per vleresimin e kapitalit.
2. Miratimin e shteses se kapitalit ne vleren 12.400.000 leke duke arritur ne kete menyre kapitali i shoqerise ne shumen 12.500.000 leke.
Depozitimin e ketyre ndryshimeve ne rregjistrin tregetar.

ORTAKUT I VETEM

Z Emin Toci



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE

NR 4412 REP
NR 4412 KOL

VERTETIM

Sot me date 31/8/ 2007 , para meje noterit publik J. Shkollu, u paraqiten personalisht : Emin Toci, i identifikuar prej meje nepermjet pasaportes perkatese, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, me cilesine e ortakut dhe administratorit te shoqerise "ELBA " sh.p.k i cili me deklaroi se dokumentin e mesiperme e ka redaktuar jasht kesaj zyre me vullnetin e tij te lire dhe e nenshkroi ate para meje. Une noterja e vertetoj ate sipas ligjit.

NOTERI PUBLIK

ELBA Sh.p.k
Import Export
TIRANE ALBANIA

KERKESE

KERKUES: Shoqeria "ELBA" shpk, e perfaqesuar nga Administratori i saj Emin Toci, madhor dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar.

OBJEKT: Depozitim e dokumentave te shoqerise "ELBA" shpk ne mbeshtetje te Ligjit 7667 dt. 28 janar 1993.

PERPARA: **GJYKATES SE RRETHIT GJYQESOR TIRANE**

Me vendim te Gjykates se Rrethit Tirane nr.5914 date 24.8.1994 eshte themeluar shoqeria "ELBA" shpk me objekt te percaktuar me hollesisht ne vendimin e saj.

Duke u mbeshtetur ne Ligjin 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" ortakut i vetem shoqerise me vendimin date 1.6.2007 ka vendosur:

1-Miratimin e raportit te ekspertit per vleresimin e kapitalit.
2-Miratimi i shteses se kapitalit ne vleren 12.400.000 leke duke arritur ne kete menyre kapitali i shoqerise ne shumen 12.500.000 leke".

3-Zgjatjen e afatit te veprimtarise se shoqerise me nje afat te pacaktuar.
Autorizoj Av Vadiola Muco te ndjeke procedurat e regjistrimit ne Gjykate.
Depozitim e kerkeses prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Sa siper i kerkoj Gjykates:

Te pranoj kerkesen per depozitim ne Regjistrin Tregtar te vendimit te ortakut te shoqerise "ELBA" shpk.

Bashkelidhur kerkeses jane:

- 1.Vendimi i Ortakut te Shoqerise.
- 2.Raporti

REPUBLICA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Notere Mimoza Shehu
Nr. 4978 Rep.

KERKUESE
Administratore e Shoqerise
Emin Toci

VERTETIM


Sot me daten 1/6/2007, ne zyren e Noterise Tirane, perpara meje Noteres Mimoza Shehu u paraqit personalisht Emin Toci me cilesine e administratorit te shoqerise i njohur personalisht prej meje i cili deklaroi se sa siper eshte nje kerkesa e redaktuar sipas vullnetit te tij e nenshkroi ne pranine time dhe une noterja legalizoj nenshkrimin sipas ligjit.



INSTITUTI EKSPERTEVE KONTABEL TE
AUTORIZUAR TE BHOJPERISE

(TEKA)

L I C E N S E



Myo license i leshohet, BUJAR PELLAN GENBO

per te ushtruar profesionin e **EKSPERTT KONTABEL TE AUTORIZUAR**.

Myo License leshohet me baze te listes se hartuar nga Komisioni i Regjistruimit
te E. M. S. dhe mbarn numrin: 79, sipas fazeve te lista.

PRESIDENTI

(BAKI BERBERI)

Lehetuar me: 18.04.2000

Republika e Shqiperise
Dhoma e Noterise Tirane
Notere Mimoza Shehu
Nr. 4332 Rep



Vertetim

Vertetoj se sot me daten 28/1 2006, ne kete zyre Noteriale u paraqit personalisht Z.Bujar Bendo,I biri I Pelivanit,banues ne Tirane,I njohur prej meje Noteres,i cili kerkoi vertetimin me origjinalin te licenses dhe une noterja si e verifikova me origjinalin vertetoj se fotokopja eshte e njejte me origjinalin dhe e vertetoj sipas ligjit

Notere
Mimoza R.Shehu

V E N D I M

I ORTAKUT TE VETEM

DATE 10.05.2007

Shoqeria "ELBA" sh.p.k është rregjistruar si person juridik me vendimin Nr 5914 date 24.08.1994 te Gjykates se Rrethit Tirane.

Sot ne mbledhjen e dates 10.04.2007 Ortaku i Vetem i shoqerise "ELBA" sh.p.k mori ne shqyrtim aktivitetin e shoqerise dhe ecurine e saj ne te ardhmen dhe ne perputhje me statutin dhe ligjin.

V E N D O S I

1. Te shtoje kapitalin e shoqerise.
2. Te caktoje si ekspert per vleresimin e kapitalit z. Bujar Bendo.
Depozitim e ketyre ndryshimeve ne rregjistrin tregetar.

ORTAKUT I VETEM

Z Emin Toci

ELBA sh.p.k
Ngjertim, Fricjektim
Import Export
TRANE ALBANIA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE
NR 4336 REP
NR 1335 KOL

VERTETIM

Sot me date 08/05 2007, para meje noterit publik Mr. Shety, u paraqiten personalisht : Emin Toci, i identifikuar prej meje nepermjet pasaportes perkatese, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, me cilesine e ortakut dhe administratorit te shoqerise "ELBA" sh.p.k i cili me deklaroi se dokumentin e mesiperm e ka redaktuar jasht kesaj zyre me vullnetin e tij te lire dhe e nenshkroi ate para meje. Une noterja e vertetoj ate sipas ligjit.


NOTERI PUBLIK



[Handwritten signature and date]
08/05/2007

E. T. Moxha
dt. 28.05.2007

KERKËSE 28 MAG. 2007



KERKUESI: Emin Toci madhore me zotesi te plote juridike , per te vepruar me cilesine e ortakut dhe administratorit te shoqerise "ELBA " sh.p.k Tirane.

OBJEKTI : Depozitimim ne Rregjistrin Tregetar te Vendimit dt 01.06.2007 Ortakut te Vetem te shoqerise "ELBA " sh.p.k Tirane.

Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

Me vendimin Nr 5914 dt 24.08.1994 te Gjykates se Rrethit Tirane eshte rregjistruar si person juridik shoqeria "ELBA " sh.p.k Tirane, me ortake dhe administrator Kapiatali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke , te cilen e zoteron 100 % ortaku i vetem z. Emin Toci

Aktualisht Ortaku i Vetem i shoqerise "ELBA " sh.p.k Tirane me vendimin date 10.5.2007 ka vendosur :

1. Miratimine Raportit te Ekspertit per vleresimin e kapitalit.
2. Miratimin e shteses se kapitalit ne vleren 12.400.000 leke duke arritur ne kete menyre kapitali i shoqerise ne shumen 12.500.000 leke.
Depozitimim e ketyre ndryshimeve ne rregjistrin tregetar.

ORTAKUT I VETEM

Z Emin Toci

ELBA sh.p.k
Ndërtim Projektim
Import Export
TIRANË ALBANIA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE

NR 2296 REP
NR _____ KOL



VERTETIM

Sot me date 26.5.2007 , para meje noterit publik M. Moxha, u paraqiten personalisht : Emin Toci, i identifikuar prej meje nepermjet pasaportes perkatese, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, me cilesine e ortakut dhe administratorit te shoqerise "ELBA " sh.p.k i cili me deklaroi se dokumentin e mesiperm e ka redaktuar jasht kesaj zyre me vullnetin e tij te lire dhe e nenshkroi ate para meje. Une noterja e vertetoj ate sipas ligjit.

NOTERI PUBLIK

K E R K E S E



5914

e

Emin Tasim Toçi, i lindur me 1951 ne Elbasan dhe banues ne Rr."Muhamet Gjollesha", pall.35 shk.2 ap.8 Tirane.

O B J E K T I : Regjistrimin e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar " E L B A ", si person juridik.

GJYKATES SE RRETHIT

T I R A N E

Ne mbeshtetje te Ligjit Nr. 7638, date 19.XI.1992 dhe Ligjit Nr.7667 date 28.01.1993, ortaku i vetem Emin Toçi kam themeluar shoqerin me pergjegjesi te kufizuar " E L B A " me seli ne qytetin e Tiranës dhe me te drejte per te ushtruar aktivitetin e saj ne te gjithë teritorin e Republikës se Shqiperise dhe jashte saj, me kohe zgjatje mbi 10 vjet, me nje kapital themeltar prej 100.000 leke, me administrator Emin Tasim Toçi dhe me aktivitet qe konsiston: Import eksport, materiale dhe prodhime te ndertimit, tregetin e tyre, ne fushen e ndertimit si dhe çdo aktivitet tjeter qe veçmas ose se bashku me ato te permendura me sipër do te ndikojn ne zhvillimin dhe ritjen e veprimtarise se shoqerise.

Meqenese aktiviteti i siperme shoqerise me pergjegjesi te kufizuar " E L B A " eshte ne perputhje te plote me legjislacionin ne fuqi te Republikës se Shqiperise, kerkojm nga ana e kesaj gjykate regjistrimin e saj si person juridik.

ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE " E L B A "

EMIN TASIM TOÇI

REPUBLIKA E SHQIPERISE

ZYRA E NOTERISE TIRANE

Nr. 608 rep. 329 kol.

V E R T E T I M

Sot, me date 18.08.1994, u paraqit ne Zyren e Noterise Tirane, Emin Tasim Toçi, i lindur ne Elbasan dhe banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi plote juridike per te vepruar, per identitetin e te cilit u sigurova nga ternjoftimi i tij personal i cili me deklaroi se kerkesa e siperme eshte perputhje me vullnetin e tij dhe e neneshkruan ate para meje. Sipas ligjit dhe une noteri e vertetoj ate rregullisht.

Handwritten signature and date:
Emin Tasim Toçi
18.08.1994

N O T E R I

E.B

GJYKATA:

TIRANE

NR. Vendimit:

5914

Data Vendimit:

24.8.1994

Adresa:

TIRANE

Lloji i Biznesit

SHPK

SHA

Administratori:

EMIN TASIM TOFI

Admin te tjere

PO

Jo

Emri i Kompanise:

ELBA